



BANKING AND PAYMENTS AUTHORITY OF KOSOVO
AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE I KOSOVËS
BANKARSKI I PLATNI AUTORITET KOSOVA

33 Garibaldi Street Prishtina Kosovo UNMIK
Phone: +381 38 222 055 Fax: +381 38 243 763 Web: www.bpk-kos.org

Në përputhje me pushtetin dhe autoritetin akorduar nga Neni 5, 6 dhe 51 i **Rregullores Nr. 2001/24** “Mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës”, **Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/4** “Mbi Monedhën e Lejuar për përdorim në Kosovë”, **Direktivës Administrative Nr. 2001/24** mbi Ndryshimin e **Direktivës Administrative Nr. 1999/2**, Zbatimin e **Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/4** dhe në përputhje me Vendimin e BQE-s BQE/2001/17 ndryshuar sipas vendimit të BQE-s/2001/14 neni 3 “Mbi zëvendësimin e kartmonedhave euro të dëmtuara”.

Nëpërmjet kësaj BPK lëshon si vijon:

Udhëzim Nr. 1

Mbi zëvendësimin e kartmonedhave euro të dëmtuara

Neni 1

Synimi i Udhëzimit

Ky Udhëzim u adresohet bankave dhe institucioneve të tjera financiare që veprojnë në Kosovë duke përfshirë institucionet mikro-financiare, operatorët e dërgimit të parave dhe këmbimoret:

Neni 2

Zëvendësimi i kartmonedhave të dëmtuara

2.1 Në bazë të kërkesës dhe sipas kushteve të parashtruara në paragrafin nr. 2, BPK-ja do të zëvendësojë kartmonedhat ligjore euro të dëmtuara në rastet e mëposhtme:

- (a) Kur paraqitet më shumë se 50% e kartmonedhës;
- (b) Kur paraqitet 50% e kartmonedhës ose më pak nëse aplikuesi provon që janë shkatërruar pjesët që mungojnë.

2.2 Zëvendësimi i kartmonedhave euro të dëmtuara do të bëhet nën kushtet e mëposhtme;

- (a) është bërë identifikimi i aplikuesit në rast dyshimi përsa i përket titullit ligjor të aplikuesit ndaj kartmonedhave dhe vërtetësisë së kartmonedhave;

- (b) janë dhënë shpjegime me shkrim lidhur me llojin e njollës, ndotjes ose lagështirës, atëherë kur paraqiten raste me njollose me bojë, ndotje ose lagështirë.
- (c) është dhënë një shpjegim me shkrim lidhur me shkakun dhe llojin e ngjyrës kur kartmonedhat dorëzohen nga bankat, institucionet financiare, operatorët e dërgimit të parave dhe këmbimoret, siç përcaktohet nga Rregullorja e BPK-s Nr. 2001/24 dhe 1999/21, nëse kartmonedhave iu është hequr ngjyra e tyre nga aktivizimi i pajisjeve kundra-vjedhjes.

2.3 Në rast se BPK-ja (Bankat) di ose ka arsye të mjaftueshme për të besuar që është kryer një shkelje kriminale ose që kartmonedhat janë dëmtuar në mënyrë të qëllimshme, atëherë ajo duhet të refuzojë zëvendësimin e tyre.

Në rast se BPK-ja di ose ka arsye të mjaftueshme për të besuar që është kryer një shkelje kriminale, kundrejt një fature pranimit, ajo do t'i mbajë kartmonedhat e dëmtuara si dëshmi për t'ua paraqitur autoriteteve kompetente për të filluar ose mbështetur një hetim të vazhdueshëm kriminal. Vetëm në rast se vendoset ndryshe nga ana e autoriteteve kompetente, kartmonedhat do t'i kthehen aplikuesit në fund të hetimit dhe më pas do të kualifikohen për zëvendësim. Nëse BPK-ja di ose ka arsye të mjaftueshme për të besuar që kartmonedhat janë dëmtuar në mënyrë të qëllimshme, atëherë ajo do t'i mbajë kartmonedhat, me qëllim që të shmangë kthimin e kartmonedhave të tilla në qarkullim ose për të parandaluar aplikuesin që t'i paraqesë ato në një bankë tjetër për zëvendësim.

Neni 3

Vendosja e tarifës për zëvendësimin e kartmonedhave euro të dëmtuara

3.1 BPK-ja do të vendosë për Bankat Komerciale, të gjitha institucionet financiare, këmbimoret, operatorët e dërgimit të parave, një tarifë në rastet kur ato i kërkojnë BPK-s në përputhje me Nenin 2 që të zëvendësojnë kartmonedhat euro që janë dëmtuar gjatë përdorimit të pajisjeve kundra-vjedhjes.

3.2 Tarifa do të jetë 1.5% e shumës nominale të kartmonedhave euro të dëmtuara.

3.3 BPK-ja do të pranojë që të zëvendësojë dhe do të vendoset tarifë nëse zëvendësohen të paktën 100 kartmonedha euro të dëmtuara. Tarifa do të vendoset për të gjitha kartmonedhat euro të dëmtuara.

Neni 4

Data e hyrjes në fuqi

Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës e miratoi Udhëzimin Nr. 1 të BPK-s më 22 Maj, 2003.